



REPUBLIKA SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
Keshilli I Basenit Ujembledhes Mat

V E N D I M

Nr.04/03 Date 17.06. 2010

Per

Pezullim te Lejes te shfrytezimit subjektit: "Dard" shpk Fan


-Ne mbeshtetje te kreu XVI te ligjit nr.8093 date 21.03.2006 "Per rezervat ujore", vendimeve te tjera te K.K.Ujit ne zbatim te ligjit "Per rezervat Ujore" u shqyrtua raporti A.U.B. Mat mbi zbatimin e ligjit nga subjektet e licensuara per shfrytezim te inerteve dhe raporti i A.U.B.Mat per ruajtjen e biodiversitetit gjate shfrytezimit te inerteve nga subjektet e kicensuara. Nga analiza e bere rezultoi qe zbatimi i kushteve te lejes nga subjektet eshte permiresuar nga viti i kaluar por kishte akoma per tu plotesuar disa kerkesa qe nuk permbusheshin.Gjithashtu kemi disa kerkesa qe dalin nga Plani i Menaxhimit te Basenit Mat, i prezantuar nga M.M.P.A.Ujrave ne Lezhe per ruajtjen e biodiversitetit te lumit Mat. AUB Mat propozon qe KBU Mat te dale me vendim per te gjitha subjektet e licensuara qe te plotesojne kushtet e Lejes se dhene se bashku me disa kushte shtese per te cilat **K.B.U.Mat:**

V E N D O S I

- 1-Pezullim te Lejes se Shfrytezimit per subjektet "Dard" shpk, "Grupo Minerario" shpk, "Pacani" shpk perse nuk kane shlyer detyrimet edhe mbas paralajmerimeve te bera nga AUB Mat.
- 2.- Subjekteve "Dard" shpk, "Grupo Minerario" shpk, "Pacani" shpk iu hiqet Leja e Shfrytezimit brenda 10 diteve nga marrja e njoftimit per pezullim te lejes se tyre, ne se ata nuk shlyejne detyrimet dhe nuk plotesojne kushtet e tjera te rehabilitimit, te vendosjes se sistemit te reperizimit, te mbjelljes se pemeve etjere sipas vendimeve te KBU Mat nr.06 date 17.06.2010.
3. Ky vendim hyn ne fuqi mbasi te njoftohet M.M.P.A.Ujrave Tirane.

PERGJEGJESI I A.U.B. MAT

Pashk NDOCI



KRYETARI I K.B.U. MAT

Pal DAJCI

